REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:213296

Datë: 25.11.2020

Numri i dokumentit: 01298746

**C.nr.1173/19**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**-Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtares Merita Baloku, në çështjen juridiko- kontestimore, të paditësit, I. (B.) G. nga ....., të cilën e përfaqëson Haxhë Nikqi, avokat në Pejë, kundër të paditurve P. (Z.) N.nga ..... B. (U.) N.nga ..... dhe V. (U.) N.nga ....., për vërtetim të pronësisë në bazë në paluajtshmeri, vlera e kontestit, 10.000 €, në seancën e shqyrtimit kryesore në prezencë të paditësit, të autorizuarit të tij dhe të paditurve B. dhe V., e në mungesë të paditurit P., me dt.25.11.2020, bie këtë:

A K T G J Y K I M
Në Bazë të Pohimit

**I.** **APROVOHET**, kërkesëpadia e paditësit I. (B.) G. nga ....., në tërësi si e bazuar dhe,

**II.** **VËRTETOHET**, se paditësi I. (B.) G. është pronar në bazë të shitblerjes së paluajtshmërisë, e evidentuar si ngastër kadastrale me numër P-71611071-05364-9 ZK Pejë, me kulturë tokë ndërtimore, shtëpi dhe oborr, në sipërfaqe të gjithmbarshme 516 m², dhe

**III.** **DETYROHEN**, të paditurit P. (Z.) N.nga ....., B. (U.) N. nga ..... dhe V. (U.) N. nga ....., që paditësit t' ia njohin të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë të përshkruar si më lartë dhe të lejojnë që të regjistrohet në librat kadastral ZKK- ....., e të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**IV.** **Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedura**.

**A r s y e t i m**

Paditësi, nëpërmjet të autorizuarit të tij ka parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 26.09.2019, kundër të paditurve për vërtetimin e pronësisë në palujtshmeri. Me padinë e ushtruar ka parashtruar çështjen si vijon: se paditësi nga i padituri i parë ka blerë shtëpinë në këtë në gjendje, të aftësuar për banim, me oborr në sipërfaqe prej 0.05.18 ha. Kanë lidhur kontratë me shkrim në të cilën janë saktësuar saktë të drejtat e tyre. Çmimi kontraktues është paguar në tërësi, ndërsa i padituri i parë ia ka dorëzuar në posedim, i cili shumë kohë më parë e ka blerë patundshmërinë sipër cekur, e cila është evidentuar në emër të paditurve tjerë B. dhe V. N.. Në shqyrtimin kryesor i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë, kërkesës së saj si dhe propozimit për nxjerrjen e provave të propozuara nga referati i padisë si dhe parashtrimeve të seancës së kaluar të mbajtur me 17.11.2020, propozoj që lidhur



2019:213297

me rrethanat e shitblerjes së kësaj patundshmërie në mes të paditurve II dhe III dhe të paditurit I, seanca e sotme të mbahet në mungesë të paditurit i P. N. i cili është ftuar në mënyrë të rregullt me procesverbalin e datë 17.11.2020 dhe e ka pranuar padinë.

I padituri P. N. në përgjigje në padi ia pranon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, ndërsa në shqyrtimin kryesor të datës 17.11.2020 ka deklaruar se: jeton në .....dhe për këtë qëllim ka ardhur. Janë të vërteta theksimet nga padia dhe deklarimet nga I. dhe i autorizuari i tij. Është e vërtetë se I. e ka blerë dhe unë e kam blerë nga familja N.. Aty ka qenë shtëpia e gatshme dhe 5 ari e diçka, Ia pranon pronësinë paditësit. Pa problem e ka marrë nga vëllezërit N. dhe pa problem ia ka shit dhe ia ka dorëzuar paditësit. Kështu që ia pranon pronësinë paditësit dhe mendon se nuk ka nevojë të paraqitet më në gjykatë për shkak të pandemisë e ka të vështirë të udhëtoi. Propozon qe gjykata të vendosë në mungesë të tij.

I padituri B. dhe V. në shqyrtimin kryesor një zëri kanë deklaruar se: „e pranojmë kërkesëpadinë në tërësi dhe nuk kemi çka të shtojmë. Megjithatë, e njoftojmë gjykatën se këtë paluajtshmëri e fillimisht babai ynë para shumë viteve dhe atë para luftës së fundit në Kosovë paluajtshmërinë lëndore ia ka pas shitur të paditurit të parë I, P. (Z.) N. nga ..... Vërtetojmë, se me rastin e kësaj shitblerje i padituri i parë ia ka paguar babait tonë shumën e tërësishme të çmimit kontraktues, ndërsa babai ia ka dorëzuar në posedim P., paluajtshmërinë lëndore. Nuk e kundërshtojmë kërkesëpadinë, ajo është realitet sepse fjalët tona u përmbyllen në këtë deklaratë, prindi ynë e ka shitur me vet dëshirë’’.

Gjykata duke vlerësuar këtë çështje kontestimore dhe duke pasur parasysh faktin se të paditurit e ka pohuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, pa shqyrtim të mëtejmë, e në kuptim të nenit 148.1 të LPK-së, ku thuhet se: ” në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, Gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejmë, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë“.

Bazuar në këtë Gjykata konform nenit 148.1 lidhur me nenin 3.1.2 të LKP-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 463.1 të LPK, meqenëse asnjëra nga palët nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË - C.nr. 1173/19, me datë 25.11.2020**

Gj y q t a r j a
Merita Baloku

KËSHILLA JURIDIKE:
Pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në Afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Këtij Aktgjykimi në Gjykatën e Apelit e përmes kësaj gjykate